



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0182
Data e Vendimit: 05.04.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenit 17 paragrafi 3 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, nenit 64 dhe nenit 65 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik (OE) “Construction Service LLC” – Mali i Zi, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën 05 prill 2023 mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e pa lejuar ankesa e datës 03.04.2023 (protokoll 182/2023) e OE “Construction Service LLC” – Mali i Zi, e ushtruar për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë.

2. I lejohet autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Prishtinë, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 03.04.2023, ka pranuar ankesë nga OE “Construction Service LLC” – Mali i Zi, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi,

dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 182/2023.

Për aktivitetin prokurimit të cekur si më lartë autoriteti kontraktues me datën 06.03.2023, ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë. Sipas verifikimit të kësaj ankesë nga zyra e pranimit të ankesave është konstatuar, se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka paraqitur fillimisht kërkesë për rishqyrtim pranë AK - Kuvendi Komunal Prishtinë po ashtu, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit siç kërkohet me piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Organi Shqyrtues i Prokurimit konsideron se duke marr parasysh faktin, se AK ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë me datën 06.03.2023 dhe B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datë 22.03.2023, OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtrij kërkesë për rishqyrtim në AK- Kuvendi Komunal Prishtinë dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, OE në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se OE ankues nuk ka ushtruar fare kërkesë për rishqyrtim pas publikimit të AK-së B05 Njoftimit për kontratë të datës 06.03.2023 dhe as pas publikimit të B54 Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datë 22.03.2023, ku sipas Njoftimit të datës 06.03.2023 afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 27.03.2023, ndërsa sipas Njoftimit B54 Formularit standard të datës 22.03.2023 afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 03.04.2023.

Nëse OE ankues nuk ishte pajtuar me kriteret e vendosura në njoftimet e lartcekura brenda afateve ligjore sipas nenit 108/A të LPP-së është dashur që fillimisht të parashtrij kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së kësaj procedure paraprake në AK dhe marrjes së një vendimi nga AK, në pajtim me nenin 109 të LPP-së të parashtrij ankesë në OSHP.

Sepse neni 109 i LPP -së specifikon: Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, për ankesën në fjalë OE ankues nuk ka ofruar dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit. Operatori ankues me rastin e paraqitjes së ankesës pranë OSHP është i obliguar të paraqes

dëshminë e pagesës së tarifës së ankesës ashtu siç kërkohet me piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Zyrtarja për të Hyra në OSHP e ka konfirmuar se në llogari të OSHP-së nuk ka mjete te deponuara nga OE “Construction Service LLC” – Mali i Zi, për ankesën me numër të protokollit 182/2023, të datës: 03.04.2023 sipas formularit të Pagesës për Depozitë për Sigurim të ankesës të ofruar nga OE në fjalë.

Prandaj, duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 03.04.2023 (protokoll 182/2023) nga OE “Construction Service LLC” – Mali i Zi, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezintusektimi dhe deratizimi i institucioneve edukative arsimore” me numër të prokurimit 616-23-1565-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar fare kërkesën për rishqyrtim kundër Njoftimit për kontratë të AK por i është drejtuar me ankesë OSHP-së si dhe nuk ofruar dëshminë e pagesës së ankimit. Pra, kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik, nenin 111 paragrafi 1.10 të LPP-së si dhenenit 64 dhe nenin 65 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund ti drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Construction Service LLC**
- Arkivës së OSHP-së: